



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 11/11

Prishtinë, më 04.05.2011, ora 11:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Hasime Krasniqi, Muhamet Mustafa, Duda Balje, Albana Fetoshi dhe Xhevdet Neziraj.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Bedri Hamza-Ministër i Financave, Lulzim Ismajli - Drejtor i Thesarit, Juergen Schatz, Ramadan Islami, Teki Shala, Njomza Ilazi nga GIZ, monitorues Zyra e Presidentit, nga KDI, OSCE.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli dhe Aurora Ademi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të komisionit, datë 18.03.2011, 23.03.2011, 28.03.2011, 29.03.2011, 30.03.2011, 06.04.2011, 08.04.2011, 13.04.2011 dhe 20.04.2011;
3. Shqyrtimi i Marrëveshjes për financimin e projektit për modernizimin e sektorit publik të nënshkruar në mes Qeverisë së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim;
I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave;
4. Shqyrtimi i Marrëveshjes për financimin e projektit për regjistrimin e pasurisë së patundshme dhe kadastër të nënshkruar në mes Qeverisë së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim;
I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave;
5. Shqyrtimi i Marrëveshjes për implementimin e softuerit ASYCUDA në Doganën e Kosovës, të nënshkruar në mes Qeverisë së Kosovës dhe UNCTAD;
I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave;
6. Shqyrtimi i Marrëveshjes për financim dhe marrëveshjen për kredi (programi për furnizim me ujë dhe largimin e ujërave të zeza në Prishtinë – faza II), të nënshkruar në

mes Qeverisë së Kosovës dhe KfW-Frankfurt am Main dhe Kompanisë së Ujësjetës Regional-Prishtina;

I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave;

7. Shqyrtimi i Marrëveshjes bilaterale të nënshkruar në mes Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Dukës së Madh të Luksemburgut për Projektin e bashkëpunimit Zhvillimor;

I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave;

8. Shqyrtimi i Marrëveshjes bilaterale për financim dhe grante të nënshkruar në mes Qeverisë së Kosovës dhe Bankës Botërore;

I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave;

9. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010,

I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave;

10. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Kontabilitet, Raportim Financiare dhe Auditim;

11. Shqyrtimi i Projekcionit të të hyrave dhe shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën 1 janar -31 dhjetor 2011;

I ftuar: Rrahman Paçarizi, Kryetar i Bordit të RTK-së;

12. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, hapi mbledhjen dhe propozoi rendin e ditës.

Rendi ditës miratohet pa ndryshime.

2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të komisionit, më datë 18.03.2011, 23.03.2011, 28.03.2011, 29.03.2011, 30.03.2011, 06.04.2011, 08.04.2011, 13.04.2011 dhe 20.04.2011**

Procesverbalet miratohen me vërejtjeje e Albana Fetoshi, e cila kërkoi për procesverbalin e mbledhjes së datës 13.04.2011, që të fshihet pjesa “*shihet që kandidati z.Gani Gërguri i përmbushë kriteret dukshëm*”.

3. **Shqyrtimi i Marrëveshjes për financimin e projektit për modernizimin e sektorit publik të nënshkruar në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim**

Bedri Hamza, lidhur me marrëveshjen konkrete, tregoi që ka një vlerë prej 8 milion\$ dhe ndahet në dy pjesë: pjesa e parë në vlerë prej \$3.6 milion, që është donacion dhe pjesa e dytë në vlerë prej \$4.4 milion që është kredi. Objektivat kryesore të këtij projekti janë: fuqizimi i performancës së organizatave kyçe buxhetore në formulimin dhe ekzekutimin e buxhetit dhe në prokurimin publik, vendosja e një baze për menaxhimin efektiv dhe të qëndrueshëm fiskal, automatizimi i proceseve të punës në administratë dhe zhvillimi i aplikacioneve të qeverisjes elektronike. Projekti do të zbatohet nga Ministria e Financave dhe nga Ministria e Administratës Publike. Aktivitetet specifike për implementimin e këtyre projekteve do të përfshijnë edhe Ministrinë e Bujqësisë, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Institutin e Kosovës për Administratë Publike.

Kryetarja, konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

REKOMANDIM

1. I rekomandohet Kuvendit të ratifikojë Marrëveshjen për financimin e projektit për modernizimin e sektorit publik në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Shoqatës ndërkombëtare për zhvillim.

4. Shqyrtimi i Marrëveshjes për financimin e projektit për regjistrimin e pasurisë së patundshme dhe kadastrë të nënshkruar në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim

Bedri Hamza, tregoi që kjo marrëveshje ka për qëllim zhvillimin e sistemit të informatave kadastrale dhe administrimit të tokës që do të ndikojë qëndrueshmërinë e tregut të pronave të paluajtshme dhe në zhvillimin ekonomik. Projekti do të financohet 55% përmes kredisë dhe 45% janë donacion.

Naser Osmani, theksoi që është vështirë të kuptohet historia e këtyre marrëveshjeve të cilat nuk kanë të bëjnë me interesat e përgjithshme shoqërore. Pyeti se a është kjo kërkesë e Qeverisë që të merren kredi për këto fusha, apo janë çështje që kanë qenë në programet e ndihmave të institucioneve ndërkombëtare për këtë destinim?

Bedri Hamza, në përgjigjen e parafolësit, njoftoi se këto janë marrëveshje që i takojnë viteve të mëhershme dhe ka qenë kusht, që për t'u fituar grantet të aprovohen si pako së bashku me kreditë, edhe pse ne kemi kërkuar që grantet të ndahen prej kredive. Zgjedhja e projekteve të cilat janë pjesë e këtyre marrëveshjeve ka qenë orientim i palëve të cilët presin që këto grante dhe kredi të investohen në fushat përkatëse.

Hykmete Bajrami, pasi që po shihet se kreditë po merren me qëllim të bashkëfinancimit të projekteve, sikur Qeveria të kishte pasur mjete për t'i bashkëfinancuar në projekte, pyeti a kishte qenë e domosdoshme që të merren këto kredi? Po ashtu pyeti se a është e sigurt Qeveria në implementimin e suksesshëm e këtyre projekteve?

Bedri Hamza, iu përgjigj se nuk është kërkuar nga Qeveria që t'i bashkëfinancojë këto projekte me ç'rast ata kanë propozuar që një pjesë të jetë grant dhe tjetra kredi. Ai shprehu besimin që këto projekte do të kontribuojnë ngritjen dhe përmirësimin e Financave Publike nëpër Ministrinë e përzgjedhura të linjës.

Xhevdet Neziraj, theksoi që problemi qëndron në atë se edhe Qeveria, Kuvendi dhe Komisioni duhet të jenë sa më vigjilentë në realizimin e këtyre projekteve, pasi që Kosova duhet të përfitojë nga këto projekte. Pasi që donatorët implementojnë vet projektet, duhet të jemi më të përgjegjshëm si institucione që këto projekte të realizohen për të mirën e Kosovës.

Jelena Bontic, pyeti se nëse nuk i realizohen kushtet nga institucionet që ofrojnë kreditë dhe grantet, a do të kemi poena të kundërt nga ana e këtyre institucioneve?

Bedri Hamza, tregoi që është parakusht që për marrëveshjet e ardhshme të bëjmë përzgjedhjen e fushave se ku do të fokusohemi nga ana e institucioneve të Kosovës dhe në rast të mosaprovimit të këtyre projekteve, atëherë natyrisht që Banka Botërore dhe institucionet tjera do të orientohen drejt vendeve tjera.

Sali Asllanaj, theksoi që dhënia e kredive dhe granteve duhet të çmohen, pasi që Kosova ka nevojë për projekte të tilla dhe nuk duhet refuzuar donacionet por edhe kreditë që shifet se janë të buta dhe në drejtim duhet dëshiruar sukses në realizimin e këtyre projekteve.

Duda Balje, theksoi se të gjithë jemi të vetëdijshëm për rëndësinë që e kanë këto projekte për vendin tonë, edhe pse kombinimi i tyre mund të jetë konfuz. Lidhur me çështjen e kadastrave, pyeti se çka do të bëhet me ato të dhëna që kanë qenë deri tani, dhe a do të merren evidencat e tanishme apo merren prej momentit kur të miratohen?

Bedri Hamza, në përgjigjen e parafolëses, u përgjigj që të dhënat dhe gjendja ekzistuese ka nevojë për përmirësime dhe ngritje dhe për këtë arsye duhet të investohet, sepse kjo gjendje e ka vështirësuar relacionin ndërmjet bankave dhe bizneseve, por edhe ndërmjet bankave dhe klientëve.

Hykmete Bajrami, pasi që projekti kadastral që dhjetë vite ka mbështetje prej donatorëve të ndryshëm, me ç'rast projektet nuk realizohen 100% për shkak të kapaciteteve të ulëta, lidhur me këtë pyeti se çfarë masash do të ndërmerren nga Qeveria për implementimin e këtyre projekteve?

Bedri Hamza, shprehu besimin në seriozitetin dhe përgjegjësinë për llogaridhënie nga ana e institucioneve të cilat janë përgjegjëse për implementimin e këtyre projekteve që do të ndikojnë në përmirësimin e gjendjes ekzistuese në të cilën ndodhen sektorët përkatëse.

Kryetarja, tregoi që Komisioni për Buxhet dhe Financa ka të drejtë të kërkojë edhe implementimin e këtyre projekteve, prandaj mund të kërkohej sqarime edhe pas ratifikimit të këtyre marrëveshjeve.

Kryetarja, konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

1. I rekomandohet Kuvendit të ratifikojë Marrëveshjen për financimin e projektit për regjistrimin e pasurisë së patundshme dhe kadastrën në mes Qeverisë Republikës së Kosovës dhe Shoqatës ndërkombëtare për zhvillim.

5. Shqyrtimi i Marrëveshjes për implementimin e softuerit ASYCUDA në Doganën e Kosovës, të nënshkruar në mes të Qeverisë së Kosovës dhe UNCTAD

Bedri Hamza, tregoi që ky projekt financohet nga UNCTAD, dhe vlerësohet se për buxhetin e Kosovës, do të ketë një kosto shtesë prej 900 mijë €, e cila veç është buxhetuar në Ministrinë e Financave. Përfitimet për Doganat e Kosovës nga ky sistem do të jenë: implementimi i procedurave standarde doganore ndërkombëtare, harmonizim i aktiviteteve në mes të Doganave dhe ATK-së, shkëmbim i informatave me administratat e vendeve tjera, përmirësim i proceseve vendimmarrëse përmes ofrimit të informatave të sakta.

Kryetarja, konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

1. I rekomandohet Kuvendit të ratifikojë Marrëveshjen në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe UNCTAD për implementimin e sistemit ASYCUDA në Doganën e Kosovës .

6. Shqyrtimi i Marrëveshjes për financim dhe marrëveshjes për kredi (programi për furnizim me ujë dhe largimin e ujërave të zeza në Prishtinë-faza II), të nënshkruar në mes të Qeverisë së Kosovës dhe KfW-Frankfurt am Main dhe Kompanisë së Ujësjetës Regjional-Prishtina

Bedri Hamza, tregoi që kjo marrëveshje ka të bëjë me furnizimin me ujë në regjionin e Prishtinës, ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe zgjerimin e rrjetit. Obligues për kthimin e kredisë është Ujësjiellësi Regjional-Prishtina, ndërsa garantues për këtë marrëveshje është Qeveria e Kosovës.

Kryetarja, konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

REKOMANDIM

1. I rekomandohet Kuvendit të ratifikojë Marrëveshjen në mes Qeverisë Republikës së Kosovës dhe KfW- Frankfurt am Main dhe Kompanisë së Ujësjiellësit Regjional – Prishtina.

7. Shqyrtimi i Marrëveshjes bilaterale të nënshkruar në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Dukës së Madh të Luksemburgut për Projektin e Bashkëpunimit Zhvillimor

Bedri Hamza, ky projekt është grant në vlerë prej 4.5 milion € për furnizimin me ujë në qytetin e Mitrovicës, ndërkaq kërkohen edhe rreth 250.000€ kredi, për të cilën është obligues Ujësjiellësi Regjional-Mitrovica, ndërsa garantues është Qeveria e Kosovës.

Kryetarja, konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

REKOMANDIM

1. I rekomandohet Kuvendit të ratifikojë Marrëveshjen bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukës së Madh të Luksemburgut.

8. Shqyrtimi i Marrëveshjes bilaterale për financim dhe grante të nënshkruar në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Bankës Botërore e 11 marsit 2011

Bedri Hamza, sqaroi se kjo marrëveshje është një kombinim grant-kredi që ka për qëllim të kontribuojë në punësim dhe kryesisht implementohet përmes tri Ministrive të linjës (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Arsimit dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale).

Në pajtim me të gjithë anëtarët e komisionit u nxor ky:

REKOMANDIM

1. I rekomandohet Kuvendit të ratifikojë Marrëveshjen për financim dhe grante ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore e 11 marsit 2011.

9. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010

Bedri Hamza, në arsyetimin e raportit theksoi se veçoritë kualitative të këtij raporti janë ngritja substanciale e të hyrave dhe tejkalimi i panit të të hyrave për disa kategori, ngritje në kategorinë investime kapitale dhe ngritje simbolike në shpenzime kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, si rezultat i zgjerimit të dukshëm të fushëveprimit të institucioneve të reja. Sa i përket strukturës së të hyrave, kemi një rritje të të hyrave nga doganat, po ashtu janë rritur edhe të hyrat e brendshme. Të hyrat komunale kanë shënuar rritje, po ashtu kemi rritje edhe në të hyrat e nivelit qendror. Në raport janë prezantuar edhe të hyrat jo tatimore qeveritare dhe grandet në përkrahje të buxhetit të dhuruare nga komisioni evropian. Është paraqitur edhe kësti i pare nga huaja e parë e nënshkruar me FMN. Të

hyrat e arkëtuare nga dividenda, janë një shumën prej 85 milion € (prej të cilave 80 milion € janë nga PTK, ndërsa 5 milion nga aeroporti). Ndërkaq po ashtu në raport janë pasqyruar edhe kthimet nga dogana e Kosovës dhe ATK-ja. Sa i përket të dalurave, duke mos përfshi grandet e përcaktuara te donatoreve si dhe fondet me mirëbesim, buxheti është realizuar 94.3% e planit të përgjithshëm, krahasuar me periudhën paraprake shihet një rritje prej 3.2%. Sa i përket strukturës, shpenzimet nga kategoria paga dhe medijtje janë realizuar në masën 98.6%, ndërsa shpenzimet për mallra dhe shërbime janë realizuar 94% të planit vjetor, shpenzimet komunale janë realizuar 77.7% ndaj planit vjetor, subvencionet dhe transferet janë realizuar 98.2%, ndërsa shpenzimet kapitale janë realizuar prej 96% dhe, krahasuar me vitin 2009, kemi një ngritje prej 13.7%. Janë bërë edhe pagesa tjera, si për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në institucionet financiare ndërkombëtar, si dhe janë kthyer një pjesë e mjeteve në emër të shlyerjes së borqit. Po ashtu është prezantuar edhe gjendja e fondeve të pa shpenzuara të përcaktuara te donatoreve.

Muhamet Mustafa, vlerësoi raportin të detalizuar sa i përket të hyrave dhe shpenzimeve, mirëpo ka nevojë për përmirësime metodologjike. Propozoi që komisioni të rekomandojë, që në raportet e ardhshme, ndryshimet në strukturë dhe dinamikë prej vitit në vit, sipas të ardhurave dhe shpenzimeve të jepen edhe në përqindje, e jo të paraqiten vetëm në shuma absolute, në mënyrë që raporti të jetë i fokusuar në objektivat e përcaktuara me politikat buxhetore se sa të jetë i fokusuar në aspektin kontabël dhe teknik, sepse kjo do të mundësojë që të shihen progreset apo problemet që janë paraqitur. Tantiema duhet të paraqitet si zë i veçantë i të ardhurave, për shkak të transparencës dhe përgjegjësisë për shfrytëzimin e pasurive natyrore. Në raport shihet që tatimi në fitim zvogëlohet në mënyrë radikale për këtë është dashur të jepen sqarime pse ka ndodhur ky ndryshim? Po ashtu vërehet edhe një rritje enorme e të ardhurave nga licenca, me ç'rast edhe për këtë është dashur ta paraqitet një analizë që e sqaron këtë rritje? Një tjetër vërejtje është se nga të ardhurat në kufij më së paku janë rritur akcizat, mirëpo objektivisht është dashur të rriten më tepër akcizat se sa të kategoritë tjera.

Bedri Hamza, tregoi për tantiemat se në faqen 15 të raportit janë të shpalosura sqarimet të cilat paraqiten edhe në tabelën e të hyrave. Zvogëlimi i tatimit në fitim ka ndodhur për shkak të ndryshimit të infrastrukturës ligjore. Për akcizat tregoi që në vitin e kaluar ka pasur një rritje të akcizave, por ka pasur edhe lirime nga akcizat për disa mallra siç është rasti i kafes, gjithashtu sqaroi se akcizat paguhën në shuma absolute, e jo në bazë të lëvizjes së çmimeve.

Hykmete Bajrami, u pajtua me z. Mustafa, duke theksuar që nga ky raport mund të analizohen vetëm numra, pa e ditur se çka qëndron prapa këtyre numrave. Nga raporti shihet që ka pasur rritje të të hyrave, por ka pasur edhe një rritje substanciale edhe te shpenzimeve. Pavarësisht kësaj, në realitet vërehen shumë projekte që nuk janë realizuar dhe kjo tregon që janë bërë më tepër shpenzime se sa që janë planifikuar. Kërkoj sqarim për pagesat e kthyer nga KEK-u si dhe për dy zërat e raportit që kanë të bëjnë me pagat dhe mëditjet, duke veçuar pagat për punë jashtë orarit, të cilat kanë shënuar lëvizje të madhe në tri vitet e fundit. Gjithashtu kërkoj sqarim edhe për pagat e delegatëve dhe komisioneve në Kuvend, të cilat për dallim nga viti 2009, në vitin 2010, kanë shënuar rënie. Rekomandoj që raporti të shoqërohet me shpjegime për realizimin e projekteve nga niveli qendror dhe ai lokal.

Xhevdet Neziraj, theksoi që përveç rritjeve që kanë qenë në dogana, në tatime e në akciza, ka pasur po ashtu rritje edhe në shpenzimet për blerjen e mobilieve, shpenzimet e reprezentacionit, shpenzimet e qirasë, dhe për këtë duhet të merren masa që të zvogëlohen, për shkak se çdo vit po ka rritje të këtyre shpenzimeve.

Naser Osmani, pyeti për trembëdhjetë organizata buxhetore të cilat i kanë tejkaluar shpenzimet e parapara me Ligjin për Buxhetin, pse ka ndodhur kjo dhe me çfarë vendime janë lejuar këto tejkalime?

Lulzim Ismajli, sqaroi se nuk mundësi teorike që të shpenzohen më tepër mjete se sa që janë planifikuar me Ligjin e Buxhetit, sepse kjo rregullohet përmes sistemit të automatizuar softuerik. Dallimet qëndrojnë te ligji fillestar kur është aprovuar në Kuvendin e Kosovës dhe në rishikimin e buxhetit, mund të jenë të hyrat që janë realizuar nga organizatat buxhetore, apo edhe transferet në fund të vitit të cilat janë ta parapara me ligj. Sa i përket pagesave të kthyer nga KEK-u kanë të bëjnë kryesisht me kredi. Te pagat sqaroi se dallimet qëndrojnë vetëm te regjistrimi nëpër kategori pagat neto dhe pagat bruto.

Kryetarja, kërkoi nga Drejtori i Thesarit që komisionit t'i paraqiten transferet që kanë mundur të ndodhin në fund të vitit dhe për cilat organizata buxhetore janë bërë transfere të tilla, në mënyrë që kemi një pasqyrë reale të të dhënave të prezantuara në raport..

Kryetarja, konstatoi se me shtatë vota për (Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontic, Duda Balje, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj, Latif Gashi dhe Xhevdet Neziraj), tri kundër (Naser Osmani, Hykmete Bajrami dhe Albana Fetoshi) dhe një abstenim (Muhamet Mustafa), komisioni nxori këtë:

REKOMANDIM

1. I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2010.
2. Ministria e Financave, në raportet e ardhshme vjetore, të prezantojë në përqindje strukturën dhe dinamikën e realizimit të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore.

10. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim

Kryetarja, tregoi se Projektligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim ka qenë objekt shqyrtimi në Komisionin për Buxhet dhe Financa edhe në mandatin e kaluar. Me qenë se projektligji i plotëson kushtet e përgjithshme, propozoi që komisioni të rekomandojë miratimin e tij në parim.

Hykmete Bajrami, dha vërejtje për përkthimin e projektligjit, i cili është i dobët, duke kërkuar investime në përkthim, në mënyrë që të shmangen keqinterpretimet e ligjit.

Kryetarja, u pajtua me deputeten për mangësitë e projektligjit në përkthim dhe tregoi që në kuadër të Kuvendit ekziston Zyra për Standardizim Ligjor dhe me bashkëpunimin e tyre dhe të GIZ-it, do të bëhen përpjekje për amendamentimin e këtij projektligji. Propozojë që të formohet grupi punues, në përbërje të Hykmete Bajrami (Kryesuese), Xhevdet Neziraj, Duda Balje Muhamet Mustafa Hasime Krasniqi, i cili do të shqyrtojë Projektligjin pas miratimit të tij në Kuvend.

Latif Gashi, propozoi që të mos humbet shumë kohë, pasi që projektligji do të kalojë edhe nëpër disa faza tjera dhe të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Kryetarja, konstatoi se Komisioni njëzëri, nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. I rekomandon Kuvendit që në shqyrtimin e parë, të miratojë në parim Projektligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.
- II. Formohet Grupi Punues, për shqyrtimin dhe amendamentimin e projektligjit, me këtë përbërje:
 1. Hykmete Bajrami – kryesuese

2. Xhevdet Neziraj
3. Duda Balje
4. Muhamet Mustafa
5. Hasime Krasniqi.

11. Shqyrtimi i Projeksionit të të hyrave dhe shpenzimeve të RTK-së në periudhën 1 janar 31 dhjetor 2011

Kryetarja, njoftoi se kërkesën e përfaqësueseve të RTK-së, të cilët kanë kërkuar të shtyhet kjo pikë në mbledhjen e radhës, për shkak se gjinden në udhëtim zyrtar.

Pika e shtatë shtyhet për shqyrtim në mbledhjen e radhës.

12. Të ndryshme

12.1. Caktimi i Grupit Punues për hartimin e Rregullores së Brendshme të Komisionit

Për hartimin e Rregullores së Brendshme të Komisionit, sipas propozimit të Kryetares, u caktuan këta anëtar:

1. Safete Hadërgjonaj, kryesuese
2. Jelena Bontic
3. Latif Gashi dhe
4. Albana Fetoshi

12.2. Caktimi i një anëtari të komisionit për grupin punues për përpilimin e dokumentacionit relevant për çështjen e digjitalizimit të qasjes në Unionin Ndërkombëtar të Telekomunikacionit, të kërkuar Komisioni i Pavarur për Media

Sipas propozimit të Kryetares, Latif Gashi delegohet si anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, në Grupin Punues për përpilimin e dokumentacionit relevant për çështjen e digjitalizimit dhe qasjes në Unionin Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU).

12.3. Z.Latif Gashi dhe znj. Albana Fetoshi, shkurtimisht njoftuan Komisionin lidhur me takimin e organizuar nga Komisionit të Pavarur për Media në Ohër, ku janë prezantuar objektivat dhe planet e veprimit të KPM-së si është diskutuar financimi i KPM-së dhe rekomandimet që kanë dalur nga ajo punëtori.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesja e Komisionit

Safete HADËRGJONAJ